



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Prilbhen / Pradato Received / Delivered	01-03-2021	viti god year	
Organ / Shëresa Organ / Jedinstvo Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Punës Appendix	Sasia Kolicitimi Quantity
SKOMBHEK 870/2021			116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.24/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 276/2020 të datës 22.01.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rr "Zejnel Salihu" nr.22 Prishtinë, kundër organit të punësimit-Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.03.2021, mori këtë .

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.24/2021 të datës 22.02.2021 të parashtruar nga ankuesja

II. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t'i ndryshojë Akt emërimit ankueses nga pozita Zyrtare e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në pozitën Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës në pozitën e Inspektore.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

IV. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e kryetarit të kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja e caktuar në pozitën Zyrtare e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për meteorologji dhe shërbime të informatave aeronautike sipas akt emërimit të datës 01.09.2014 i nënshkruar me datën 30.08.2014, më datën 27.08.2020 ka bërë kërkesë me numër protokollit 2020/ADM/BNJ/33, për Drejtorin Gjeneral të Aviacionit Civil të Kosovës pasi që ka plotësuar kushtet sipas Manualit të Trajnimeve që parasheh formën dhe mënyrën për të fituar kredencialet për Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe se Kredencialet për Inspektore i janë dhënë me 15.07.2016 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Aviacionit Civil të Kosovës përkundër që e ka ushtruar edhe aktualisht është duke kryer këto detyra të Inspektore por se deri më tani ende nuk ka marrë ndonjë

përgjigje zyrtare në lidhje me këtë kërkesë dhe poashtu as nuk i është ndërrue akt emërimi sipas kërkesës dhe përgjegjësi qe i kryen ankuesja.

Ankuesja pasi nuk mori përgjigje dhe nuk pati ndonjë veprim konkretë administrativë për ti ndërrue aktemërimin nga Drejtori Gjeneral i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës lidhur me kërkesën e datës 27.08.2020, ka parashtruar ankesë me datën 20.10.2020 me numër protokolli 2157/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.10.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoritetit të Aviacionit Civil. Me datën 04.11.2020 Autoriteti i Aviacionit Civil ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar dhe me datën 30.11.2020 ankuesja ka sjellë në Këshill prova shtesë lidhur me ankesën faqe 1/363.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.12.2020 ka nxjerrë Vendimin A.nr.310/2020 me të cilin ka obliguar Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil që të bëjë rishqyrtimin e kërkesës me numër protokolli 2020/ADM/BNJ/33, të datës 27.08.2020 të parashtruar nga ankuesja

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, nuk ka nxjerrë fare vendim por me datën 05.01.2021 ka njoftuar Këshillin se ka shqyrtuar kërkesën me numër protokolli 2020/ADM/BNJ/33 të ankueses por nuk ka nxjerrë vendim.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 05.01.2021 me numër 2021/ZDP/02 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 22.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 276/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2157/2020 të datës 20.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresë e datës 15.07.2016; Kërkesë e datës 27.08.2020; Kredencialet e Inspektorit te ankueses; Kërkesë për përgjigje e datës 26.10.2020; Përgjigja ne kërkesë e datës 23.11.2020; Emali zyrtar i datës 20.10.2020; Përshkrimi i detyrave te punës i ankueses i datës 15.01.2013; Emali zyrtar i datës 02.10.2020; Emali zyrtar i datës 29.09.2020; Akt emërimi i ankueses i datës 30.08.2014; Prova shtese te datës 30.11.2020; Rregullorja Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektoreve; Shkresa e datës 26.12.2017; Raporti i Auditimit i realizuar ne Agjencinë e Shërbimeve te Navigacionit Ajror date 04-08 Dhjetor 2017; Shkresë e datës 16.11.2019; Raporti i Auditimit i realizuar ne Agjencinë e Shërbimeve te Navigacionit Ajror date 22-25 Tetor 2018; Dorëzimi i raportit final te Auditimit te realizuar ne Agjencinë e Shërbimeve te Navigacionit Ajror date 23.03.2019; Raporti i Auditimit i realizuar ne Agjencinë e Shërbimeve te Navigacionit Ajror date 25shkurt deri me 01 mars 2019; Dorëzimi i raportit final te Auditimit te realizuar ne Agjencinë e Shërbimeve te Navigacionit Ajror date 04.03.2020; Raporti i Auditimit i realizuar ne Agjencinë e Shërbimeve te Navigacionit Ajror date 03-07 gusht 2020; Emali zyrtar i datës 15.09.2020; Emali zyrtar i datës 10.06.2020; Emali zyrtar i datës 11.01.2019; Emali zyrtar i datës 30.10.2020; Emali zyrtar i datës 06.08.2020; Emali zyrtar i datës 12.10.2020; Emali zyrtar i datës 09.11.2020; Emali zyrtar i datës 04.11.2020; Emali zyrtar i datës 03.11.2020; Letër përcjellëse e datës 14.10.2020; Diploma e studimeve themelore e ankuese e datës 06.06.2013; Diploma e studimeve master e ankueses; Certifikata e datës 02.10.2015; Certifikata e datës 18.12.2015; Certifikatë e trajnimit e datës 21.01.2016; Certifikatë e datës 17.10.2014; Certifikatë e datës 26.05.2014; Certifikatë e datës 06.11.2015; Certifikatë e datës 11.10.2013; Certifikatë e datës 07.06.2014; Certifikatë e datës 02.11.2015; Certifikatë e datës 23.10.2017; Certifikatë e datës 23.03.2017; Certifikatë e datës 16.06.2015; Certifikatë e datës

15.09.2016; Certifikatë e datës 18.03.2016; Certifikatë e datës 12.05.2017; Certifikatë e datës 12.05.2017; Certifikatë e datës 03.02.2017; Certifikatë e datës 16.11.2017; Certifikatë e datës 26.10.2017; Akt emërimi i ankueses i datës 30.08.2014; Dorëzimi i Raportit Final të Auditimit të realizuar në ANP "Adem Jashari" datë 02-06 dhjetor 2013; Raporti i Auditimit të realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror datë 18.07.2016; Letër rekomandim për ankuesin i datës 12.07.2016; Kërkesë e datës 12.07.2016 për emërimin e ankueses e pozitën inspektor i SHNA-se; Aplikacioni i ankueses për Kredenciale të Inspektorit; Formular vlerësimi për inspektor i datës 16.06.2014; Formular i vlerësimit i datës 15.01.2020; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 29.12.2016; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës për vitin 2017; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 2018; Vendimi i datës 11.05.2016 për plotësim ndryshimin e vendimit Nr.15.2012; Auditimi i Brendshëm i datës 15-17.10.2018; Manuali i cilësisë i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës i datës 25.04.2016; Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektoreve; Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil; Prova shtese të datës 31.11.2020; Formular i Auditimit i datës 04.09.2017; Formular i Auditimit i datës 8-22.06.2018; Emali zyrtar i datës 30.10.2020; Emali zyrtar i datës 06.08.2020; Emali zyrtar i datës 12.10.2020; Emali zyrtar i datës 09.11.2020; Emali zyrtar i datës 04.11.2020; Emali zyrtar i datës 03.11.2020; Raporti i Auditimit të realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror datë 26.12.2017; Raporti i Auditimit të realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror datë 04.09.2020; Raporti i Auditimit të realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror datë 22.03.2019; Raporti i Auditimit të realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror datë 16.1.2018. Ankesa e datës 22.01.2021 me numër protokollit 276/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2014; Kërkesë e datës 27.08.2020; Ankesa e datës 20.10.2020 me numër protokollit 2157/2020 e parashtruar në KPMSHCK; Prova shtesë të datës 30.11.2020; Vendimi i datës 15.12.2020 me numër protokollit 3158/2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 05.01.2021; Përshkrimi i detyrave të punës; koncept dokumenti nëntorë 2020; E-mail zyrtar i datës 16.11.2020; Raporti i punës i datës 15.11.2020; E-mail zyrtar i datës 22.07.2020; E-mail zyrtar i datës 13.07.2020; Vendimi i datës 01.12.2020 me numër protokollit 2871 për shtyrje të afatit; Akt emërimi i datës 30.08.2013 dhe Lista e inspektorëve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 18 paragrafit 1.2,1.3 dhe 1.4 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që të aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e ankueses.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Ankuesja me datën 27.08.2020 ka parashtruar kërkesë për Drejtorin Gjeneral të Aviacionit Civil, me arsyetimin se kredencialet për inspektor ankueses i janë dhënë me 15.07.2016 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës edhe se që nga ajo kohë ankuesja kryen detyrat dhe përgjegjësit e Inspektorit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, por deri më tani institucioni nuk ka reflektuar as në ndryshimin e akt emërimit e as në rritjen e pagës. Në kërkesën e datës 27.08.2020 ankuesja nga Drejtori Gjeneral i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka kërkuar që t'i bëhet ndryshimi i akt emërimit nga zyrtarë në Inspektor sipas kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të përshkruara në "Inspektor's Delegation" dhe të rimbursohet për ndryshimin/diferencën në pagë që nga muaji korrik 2016.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2,1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pasur parasysh faktin se ankuesja ka bërë disa kërkesa në adresë të zyrtarëve kompetentë të institucionit përkatës që të rregullojë këtë çështje që lidhet me këtë ankesë, por se nga shkresat e lëndës dhe përgjigja nga institucioni kompetentë në lidhje me këtë ankesë nuk kemi hasur në ndonjë veprim konkretë

administrativë që merrë në shqyrtim këtë kërkesë me qëllim që të nxjerrin ndonjë akt administrativë në lidhje me këtë kërkesë, andaj mbi këtë bazë të potencuar më lartë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendimin e datës 15.12.2021 me numër protokollit kishte obliguar Drejtorin Gjeneral të Autoritetit të Aviacionit Civil që të shqyrtojë kërkesën e ankuesës dhe me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 27.08.2020, të veproj konformë legjislacionit në fuqi që rregullonë këtë çështje duke nxjerrë një aktë administrativë sipas kësaj kërkesë/ankese konformë dispozitave ligjore në fuqi, nga se kolegji vlerëson se është obligim i organit kompetentë të punësimit që të përgjigjet konformë dispozitave të LPPA-së(Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative) ndajë çdo kërkesë që adresohet përmes procedurave administrative.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit të Kosovës, nuk ka nxjerrë vendim por me datën 05.01.2021 përmesë një njoftimi arsyetohet se ankuesja ende e ka akt emërimin si zyrtare dhe jo si inspektore dhe sipas përshkrimit të detyrave të punës që ju bëni në departament nuk ka ndonjë ndryshim.

Ankuesja e paknaqur me njoftimin e datës 05.01.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datën 22.01.2021 ka parashtuar ankesë me numër protokollit 276/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për ndryshimin e Akt emërimit nga pozita Zyrtare e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në pozitën Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të ankesës ka konstatuar se ky pretendim ankimor i ankueses është i bazuar pjesërisht, sepse ankueses që nga data 15.07.2016 sipas shkresës Ref:AACK/ADM/BNJ-33 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil i janë deleguar detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, mirëpo kjo nuk është reflektuar as në Akt emërim as në pagë ,dhe se sipas shkresës së datës 23 Nëntor 2020 të dërguar nga udhëheqësja e personelit të institucionit është konfirmuar se ka qenë buxheti problem sa i përket çështjes së rritjes së gradës apo koeficientit në këtë rast dhe se për çdo avancim në gradë apo koeficient kërkohen procedurat adekuate ligjore, ndërsa kolegji me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde një praktik e tillë siç përshkruhet në këtë shkresë nuk është zbatuar edhe e për zyrtarët tjerë të cilët janë avancuar nga pozita e zyrtarit në pozitën e Inspektorit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Pas vitit 2012 deri në vitin 2014, tre zyrtar të AACK-së kanë marr pozitën e inspektorit pas marrjes se kredencialeve sipas dispozitave te veçanta të AACK-se, ndërsa ndaj ankueses organi i punësimit nuk ka vepruar me standardë të njëjtë edhe pse ankuesja ka marr kredencialet sipas Rregullores Nr.08/2011 mbi Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave po ashtu ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankueses lidhur me përshkrimin e detyrave të punës e cila bazohet në njoftimin e datës 05.01.2021 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës i cili thekson se “Sipas përshkrimit të detyrave të punës, nuk keni pas ndonjë ndryshim të detyrave që do të reflektonte ndryshimin e përgjegjësiave të punës që ju bëni në departament, sipas Akt emërimit ju ende jeni zyrtare dhe jo inspektore”, andaj Këshilli ka konstatuar se ky pretendim i ankueses është i qëndrueshëm sepse në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.08/2011 “Autorizimet e inspektorëve të AAC-së” përshkruhen detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit ku inspektori ka përgjegjësi të kryej/realizoj audite/inspektime dhe të harton raportet e auditimeve /inspektimeve ndërsa zyrtari ka përgjegjësi që të ofrojë përkrahje në procesin e Auditimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave posedon listën e inspektorëve për nënshkrim që është dokument zyrtarë i organit të punësimit ku në atë listë është edhe emri i ankueses Albulena Gërxfhalii ANS inspektor SHNA CAA-16/2017,po ashtu ankuesja posedon edhe ID kartelën inspektore e

autorizuar e AAC-së,CAA-15/2016 e datës lëshimit 01/02/2020 deri më datë 31/01/2022 ku saktësohen veprimet që mund ti ndërmerren në përputhje me nenin 15.1(h) të Ligjit Nr.03/L-051 për Aviacionin Civil dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se organi i punësimit në këtë rast Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës i ka lëshuar kredencialet e inspektorit ankueses,ka lëshuar ID-kartelen e potencuar më lartë ku figuron emërtimi i pozitës zyrtare si Inspektore, përshkrimi i detyrave që kryen ankuesja janë në përputhje të plotë me përgjegjësit që i takojnë si Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror sipas shkresës mbi delegimin e përgjegjësiive Ref:AACK/ADM/BNJ-33,poashtu nga shqyrtimi i ankesës dhe provave që janë administruar konstatohet fakti se ankuesja është duke e ushtruar detyrën e Inspektorese Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe përderisa nuk kemi ndonjë dokument zyrtarë që i janë ndërrue përgjegjësit sipas përshkrimit të detyrave të punës është obligim i zyrtarit kryesorë administrativë në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil që ankueses të i lëshoj akt emërimin si Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror konformë legjislacionit në fuqi në lidhje me këtë çështje.

Kolegji mbi bazë të shkresave të lëndës konstaton se ankuesja është duke e ushtruar detyrën e Inspektorese Shërbimeve të Navigacionit Ajror përkundër që nuk i është lëshuar akt emërimi dhe me qenë se është parim në shërbimin civil që për punë të njëjtë edhe paga duhet të jetë e njëjtë dhe në këtë kontekst me qenë se për nivelin e njëjtë të zyrtarëve të kësaj kategorie nuk ka pasur procedura të veçanta të avancimit sa i përket pozitës dhe gradës/koefficientit por se i janë ndërruar akt emërimet mbi bazë të delegimit të përgjegjësiive respektivisht kredencialeve të fituara për inspektor andaj edhe mbi këtë bazë kolegji vlerëson se në këtë aspektë duke mos lejuar që të shkaktohet ndonjë diskriminim që është një nga parimet bazë në administratën publike dhe shërbimin civil andaj edhe mbi këtë bazë konsiderojmë se ankesa është e bazuar pjesërishtë sa i përket qështjes së aktemërimit.

Andaj bazuar në dispozitat e Ligjit për Aviacion Civil Nr.03/L-051, Rregulloren Nr.08/2011 për autorizimet dhe kredencialet e inspektorëve, Urdhëresën administrative 02-2011 për procedurat e lëshimit të kredencialeve , Këshilli obligon Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t'i ndryshojë Akt emërimin ankueses nga pozita Zyrtare e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në pozitën Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës në pozitën e Inspektorese.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi,Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës,pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit,vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.24/2021, datë 01.03.2021

Sabije Avdyli
Sabije Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

